
	<b>KLASIFIKIMI I GRUPEVE TË SIGURIMIT TEKNIK</b>	PT .07
		Data 10.10.2016
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 1	

Hartoi	Miratoi
Menaxheri i Cilësisë	Drejtori I Trupit Certifikues

	<b>KLASIFIKIMI I GRUPEVE TË SIGURIMIT TEKNIK</b>	PT .07
		Data 10.10.2016
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 1	

## 1. FUSHA E ZBATIMIT

Proçedura përcakton kriteret dhe mënyrën e ndarjes së grupeve të sigurimit teknik elektrik sipas referencave ligjore.

## 2. REFERENCA

- Standardi ISO /IEC 17024 : 2012, Vlerësimi i konformitetit – Rregulla të përgjithshme për organizmat që operojnë në çertifikimin e personit.
- Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike”
- Ligjin Nr. 8734 datë 01.02.2001“Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike”.

## 3. KLASIFIKIMI I GRUPEVE

### 3.1 GRUPI I PARË I SIGURIMIT TEKNIK

Në grupin e I- rë të sigurimit teknik elektrik kalifikohen punonjësit e thjeshtë, (bojaxhinj, punonjës provë, apo personeli i reparteve të centralit, të cilët nuk duhet të njohin rregulloren e sigurimit teknik, psh pastrues të impianteve, mekanikë, saldatorë, drejtues të vinçave, etj).

Sipas përcaktimit në Rregulloren e sigurimit Teknik është përcaktuar si moshë minimale, mosha 16 vjeçare.

Kriteret që duhet të plotësojnë janë persona të cilët nuk kanë përgatitje elektroteknike, por njohuri fillestare mbi rrezikun elektrik dhe masat e sigurimit teknik ku shërbejnë.

Kjo kategori, duhet të ketë njohuri mbi rregullat e dhënies së ndihmës së pare.

	<b>KLASIFIKIMI I GRUPEVE TË SIGURIMIT TEKNIK</b>	PT .07
		Data 10.10.2016
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 1	

### 3.2 GRUPI I DYTE I SIGURIMIT TEKNIK

Grupi i dytë i përket praktikantëve të shkollave profesionale elektrike dhe inxhinierisë, kontrollorëve të linjave, saldatorëve, telefonistëve, elektropompistëve, të gjithë elektrikistëve me kualifikim të ulët.

Mosha : Jo më pak se 16 vjeç

Kriteret :

Eksperienca në punë jo më pak se 1 vit në profilin përkatës. Në këtë vjetërsi nuk përfshihet koha e punës si praktikant.

Duhet të kenë njohuri fillestare mbi rrezikun që paraqet rryma elektrike dhe afrimi në paisje që kanë tension apo rrymë elektrike, masat mbrojtëse gjatë punimeve pranë impianteve elektrike, si dhe njohuri për dhënien e ndihmës së parë.

### 3.3 GRUPI I TRETË I SIGURIMIT TEKNIK


Grupi i tretë i përket personelit elektromekanik, elektroteknik, gjithë specialistëve përgjegjës të ndërtesës në central, nënsta, impiante shpërndarëse dhe një rrjetin elektrik , dhe personelit elektrik që punojnë në kompanitë e telekomunikacionit.

Sipas përcaktimit në Rregulloren e sigurimit Teknik është përcaktuar si moshë minimale, mosha 18 vjeçare.

Kriteret që duhet të plotësojnë janë si vijon:

a. Eksperienca në punë: Jo më pak se 6 muaj në grupin e dytë të sigurimit teknik dhe kanë përfunduar edukimin 8 – vjeçar dhe kurs kualifikimi të plotë ose në shkallë të ulët profesionale për specialitetin.

b. Jo më pak se 3 muaj për personat që përfundojnë edukimin e mesëm profesional.

	<b>KLASIFIKIMI I GRUPEVE TË SIGURIMIT TEKNIK</b>	PT .07
		Data 10.10.2016
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 1	

c. Jo më pak se 1 muaj për personat që përfundojnë arsimin e lartë për inxhinierë.

Në këtë kategori duhet të kenë njohuri mbi elektroteknikën në volumin e shkollës së ulët profesionale, mbi rrezikun që paraqet rryma elektrike gjatë punimeve në paisje apo objekte që ata shërbejnë. Gjithashtu duhet të kenë njohuri mbi rregullat e lejimit të brigadave në punimet elektrike, të dijnë të kontrollojnë ata që punojnë në linja apo impiante elektrike, dhe të zotërojnë njohuritë për dhënien e ndihmës së shpejtë.

Kjo kategori, duhet të ketë njohuri mbi rregullat e dhënies së ndihmës së pare.

### **3.4 GRUPI I KATËRT I SIGURIMIT TEKNIK**

Në Grupin e katërt të sigurimit teknik elektrik ju u përket: Teknikëve dhe inxhinierëve të rinj, personelit në central nënstacione dhe rrjete elektrike, elektroteknik, mjeshtër elektromontier.

Mosha - Jo më pak se 20 vjeç

Eksperienca në punë - Jo më pak se 2 vjet në grupin e III të sigurimit teknik, ndërsa për personat që kanë mbaruar shkollë specialiteti jo më pak se 1 vit në grupin e III. Inxhinierët dhe tekniket e rinj duhet të kenë një stazh në punë në impiantet dhe linjat elektrike mbi tre muaj.

Duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në impiantet elektrike. Gjithshtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë në përcaktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojnë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik, si dhe të dijë të ushtrojë kontroll mbi punonjësit gjatë punimeve.

Gjithashtu të dijë rregullat e ndihmës së shpejtë dhe të japë paraprakisht ndihmën e parë në rast aksidentesh.

	<b>KLASIFIKIMI I GRUPEVE TË SIGURIMIT TEKNIK</b>	PT .07
		Data 10.10.2016
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 1	

### 3.5 GRUPI I PESTË I SIGURIMIT TEKNIK ELEKTRIK.

Grupi i pestë i sigurimit teknik elektrik u përket mjeshtrëve, teknikëve elektrikë dhe inxhinierëve.

Mosha - Jo më pak se 24 vjeç

Eksperienca në punë - Për mjeshtrat mbi 10 vjet në prodhim dhe mbi 3 vjet në grupin e pestë të sigurimit teknik. Për teknikët duhet të kenë 3 vjet punë në grupin e IV të sigurimit teknik. Për inxhinierët të kenë stazh pune prej një viti në impiantet ose linjat elektrike.

Këta persona duhet të kenë njohuri të plota të:

- Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik dhe, mbi rregullat e provave dhe përdorimit të mjeteve mbrojtëse;
- Aftësi të plota për organizimin e punimeve në impiante dhe linjat elektrike, si dhe për mbikëqyrjen e punonjësve gjatë punës;
- Njohjen e plotë të skemës së impiantit, të karakteristikave të pajisjeve, të vendosjes së pajisjeve të sektorit të punës së tij.


Gjithashtu të dijë rregullat e ndihmës së shpejtë dhe të japë paraprakisht ndihmën e parë në rast aksidentesh.

### 4. KRITERET E SIGURIMIT TEKNIK ELEKTRIK

Referuar Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike”, janë përcaktuar:

1- Kriteria të Përgjithshme sipas të cilave:

- Personi duhet të ketë mbushur moshën e përcaktuar nga ligji
- Është i aftë për punë

	<b>KLASIFIKIMI I GRUPEVE TË SIGURIMIT TEKNIK</b>	PT .07
		Data 10.10.2016
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 1	

- Shkruan, lexon dhe komunikon rrjedhshëm në gjuhën shqipe

Kriteret e veçanta të sigurimit teknik elektrik, janë përcaktuar më sipër në varësi të grupit të sigurimit teknik elektrik për të cilin aplikanti kërkon të Çertifikohet nga Organizmi.

## 5. LEGJENDA E NDRYSHIMEVE

Nr. Rishikimit	Seksioni i rishikuar	Detaje të rishikimit	Autori	Datë